

# **S H E F K I O S E K U**

**Një lloj drite tjetër**  
Another type of light

**Poezia shqipe-anglisht**  
Poetry in Albanian with English interpretation

---

Përkthyer nga shqipja në anglisht  
Translated from Albanian to English

**Ferhat Ymeri**  
**Jennifer Claesson**

---

**Përpunimi kompjuterik**  
**Computer responsibility:**  
**Frashër Oseku**

---

**Botimi i parë, tirazhi 1.000 copë**  
**First publication, 1.000 examples**

---

**Libri u botua me ndihmën e ABF-it në Treleborg-Suedi**  
**The book is published with help of ABF in Trelleborg-Sweden**

---

**U dorëzua në shtyp në janar të vitit 2008**  
**Print date Januari 2008**

**BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG, SUEDI, 2008**  
**Published by the journal of "Drita" Trelleborg, Sweden, 2008**

**Me mirënjohje presidentit të SHBA-ve, z. Bil Klinton, Kryeministrit të Britanisë së Madhe, z. Toni Bler si dhe vendeve anëtare të NATO-s, për ndihmën e dhënë Kosovës.**

**A big thank you to the President of the USA, Bill Clinton, and the Prime minister, Great Britain, Tony Blair, and other NATO countries for helping Kosova.**

## **SOME COMMENTS BY THE TRANSLATOR IN SWEDISH**

For an average Swedish reader, whether he has experience of poetry or not, the poetry collection “‘Another Type of Light’” is challenging both emotionally and intellectually. It starts with at least a dozen poems that have the fate of the Albanian people’ and their relationship with the world around them as a main motive. In his poetry, Shefki Oseku wants to show that his people have been victims of denial, amputation, massacre, lawlessness and an attempt at banishment and assimilation for over 120 years.

The author speaks out passionately in these poems about his hatred - towards the enemy and those who have betrayed his people. This is not typical for Sweden today and one must go back to the nationalist poet Heidenstam to find similar tones in Swedish Literature. Our Swedish 'ombudsman' spirit is against this unforgiving hatred and memory of wrong doings.

Almost 100 years ago, when the Great Powers - through their creation of boundaries - divided the Albanian Nation, the Albanian settlements ended up not only in the mutilated state of Albania but also within the borders of Montenegro, Serbia, Macedonia and Greece – and this still throws its shadow over politics and society life in the Balkans.

The conditions needed for healing the injury have not yet been established. And one of these important conditions is justice, another one is equal relations between all peoples and nations in the Balkans. Only then can hatred, racism, discrimination and distrust be removed. Then gradually the borders will also lose their meaning. But unfortunately the road to get there is still long.

Shefki Oseku’s political and human perceptions are coloured also by his own personal experiences of police maltreatment and torture that he experienced in his younger years.

The author conveys a message of pain, but when it concerns his people’ s future, this is not linked with capitulation. He is an optimist in spite of the total distrust he displays towards the actions of the Great Powers’, towards their hypocrisy and their treachery against people’s rights and the need for a peace that is worth its name.

But the poet Shefki Oseku has capitulated nevertheless - on the purely personal plane. The last part of the poet’s collection conveys his experiences of love’s great sweetness - and equally great pain. In these poems love wanders her path, incomprehensible and tremendous, right unto the inevitable end. And there the poet has surrendered before the powers against which no fight is possible. But for his love he has raised a monument of honour in poetry.

Those who take time to read this dynamic poetry will not remain indifferent towards it. The conditions for us in the Scandinavian countries to understand it completely in all its dimensions hardly exist. But out of this rich mosaic there is much to take in for those who read without prejudice. And poetry - if it really is poetry - means - challenge.

**Norrköping, Sweden, 20<sup>th</sup> March 2003  
Ullmar Qvick, Specialist of Albanian ,  
Union of Swedish Authors, Translators' Section.**

## Dy fjalë nga përkthyesi i librit në suedisht

Për lexuesin mesatar suedez, qoftë ky mashkull apo femër, që ka ose jo njohuri mbi poezinë, përmbledhja e poezive "Një lloj drite tjetër" është një nxitje për mëtim dhe ndiesi. Kjo përmbledhje fillon me afro njëzet vjersha, të cilat e kanë për lajtmotiv fatin e popullit shqiptar si dhe marrëdhëniet e tij me botën. Shefki Oseku me poezinë së tij don ta bëj të ditur botërisht se populli i vet ka qenë viktimë e mohuar, e amputuar, e masakruar, e pambrojtur dhe e dëbuar apo e asimiluar gjatë këtyre 120 vjetëve të fundit.

I frustruar dhe eksploziv, shkrimtari në këto poezi i anatemon armiqtë dhe ata që e kanë tradhëtuar popullin e tij. Kjo nuk është tipike për Suedinë e sotme, ndaj ne duhet t'i referohemi të kaluarës sonë – Haidestamit (poet romantik suedez - vërejtje e përkthyesit!), në mënyrë që të gjejmë tone të ngajshme në literaturën suedeze. Shpirti ynë pajtimtar nuk e pranon urrejtjen e pafre dhe mbamendjen e së keqes.

Pothuajse njëqind vite më parë, kur Fuqitë e Mëdha e gjymtonin kombin shqiptar duke i vënë kufinjte - trojet shqiptare u futën nën sovranitetin e shtetit të coptuar të Shqipërisë, por, edhe nën atë të Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë, si dhe brenda kufinjve të Greqisë – gjë që prore hedhë hije ndaj politikës dhe jetës shoqërore në Ballkan.

Ende nuk janë plotësuarr parakushtet që plaga të shërohet. Dhe, një nga këto parakushte të rëndësishme është drejtësia si dhe marrëdhëniet e barazisë mes të gjithë popujve e kombeve të Ballkanit. Pikërisht kështu zhduket urrejtja, racizmi, diskriminimi, dhe mosbesimi. Atëbotë edhe kufinjte do ta humbisnin rëndësinë e vetë. Por, fatkeqësisht, për të arritur deri atje - rruga është tepër e gjatë.

Vështrimi politik dhe njerëzor i Shefki Osekut është i ngjyrosur edhe nga përjetimet e tija tejet personale - nga tortura dhe keqtrajtimi policor, ndaj të cilave ky ka qenë i ekspozuar që në moshën e vet rinore.

Shkrimtari e pasqyron dhembjen, por kur kemi të bëjmë me të ardhmen e popullit të tij - kjo nuk mund të nënkuptohet si kapitulum. Ai, në të vërtetë, është optimist, përkundër të dhënës se në poezinë e tij shfaqet një mosbesim i plotë ndaj veprimeve të Fuqive të Mëdha, para së gjithash për hipokrizinë dhe tradhëtinë e tyre ndaj të drejtës së popujve dhe nevojave të tyre për liri, e cila do të ishte, vërtet, e denjë për emrin e vet.

Por, megjithatë, Shefki Oseku ka kapitulluar - në planin e pastër personal. Në pjesën tjetër të përmbledhjes me poezi pasqyrohet ndjenja e fuqishme kënaqësisë e cila përjetohet gjatë dashurisë si dhe plagët e mëdha që më vonë i shkakton kjo. Në këto poezi dashuria shtegton udhëve të veta, në mënyrë të pakuptueshme dhe të paparashikueshme, deri tek përfundimi i vet i pashmangshëm. Dhe pikërisht këtu ka kapitulluar poeti, para atyre forcave, ndaj të cilave asnjë luftë nuk është e mundur. Por, dashurisë së tij ky ai ka ndërtuar një përmendore në poezi.

Ai që i falë pak kohë leximit të kësaj përmbledhjeje poetike, nuk mund të jetë indiferent ndaj saj. Parakushtet për ne në Skandinavi që ta kuptojmë këtë poezi në të gjitha përmasat, janë shumë të vogla. Por, nga ky mozaik i pasur mund të merr shumëçka ai që e lexon pa paparagjykime. Dhe poezia – nëse vërtet është poezi – do të thotë sfidim.

Norrköping, Suedi, më 20 mars 2003

Ulmar Kvik, përkthyes, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Suedisë.

**NËNËS**  
**TO MOTHER**

**N Ë N Ë S**

**shumësin ta kanë krijuar  
gramatikanët marroqë**

**TO MOTHER**

**to speak of you in the plural  
is the invention of foolish linguists**

## **KRUSHQIT**

**hipur mbi kuaj, mbi qerre me qilima mbuluar  
nisen për ta marrë nusen, fillin e jetës  
e larg, shumë larg, jehon kënga e tyre**

**-j-o-o-o, p-o-o-o!**

**-j-o-o-o, p-o-o-o!**

**thua qindra herë e kanë lexuar Hamletin  
fshatarët e mi analfabetë**

**-j-o-o-o, p-o-o-o!**

**-j-o-o-o, p-o-o-o!**



## **BRIDEGROOM ESCORTS \***

**on their horses, on wagons covered with ornamental rugs  
they set out to fetch the bride, life's beginning  
far and wide their song echoes  
no, yes! no, yes! no, yes!  
no, yes! no, yes! no, yes!**

**one would say they have read Hamlet hundreds of times  
these illiterates from the village**

**no, yes! no, yes! no, yes!  
no, yes! no, yes! no, yes!**

---

**\* "Krushqit" (in Albanian) translated: "The Bridegroom Escorts"  
symbolize the participants of massive Kosova demonstrations  
in 1981.**

**( written 1981 )**

## **NUSJA**

**ditë e re, e  
ajo askund s'po duket  
nusërimi mbrëmë dhe e mërkura  
kurrresi s'po e lëshojnë të kthehet  
prej shtegut, prej lisit, prej kroit...  
e krushqit po presin!  
mos motër, gjë e ligë mos e gjettë shtëpinë e babës!  
lotët e tu mbi kufomën e vashërisë pikojnë  
që sonte po varroset diku larg  
pas shtatë bjeshkësh  
në gjerdekun e panjohur**

## **THE BRIDE \***

**a new day  
and she is nowhere to be found  
the eve of the wedding and the mystery of the new day  
does not let her go  
from her girlhood paths, oaks, and springs  
and the escorts are waiting!  
no, sister, may this evil not befall your father's house!  
your tears drip over the sunset of girlhood  
that tonight will be buried far away  
beyond seven mountains  
in the unknown bridal chamber**

---

**\*Bride is a symbol of freedom**

**( written 1981)**

## **DHËNDRI**

**po vijnë krushqit rrzës së malit...**

**dy fshatarë iu ngjitkan një shpati  
vallë, pse nxitojnë kaq shumë?  
kërkokan drunj gështenje dhe  
pa bëza rrëmokan, një varr  
as të cekët, as të thellë  
jo nënëlokes, e cila mordjes së vet moti i ka dredhuar,  
veç djalit të dëshirit  
që po ia mbyll të Nesërmen me therrë  
po, ajo gjallë se gjallë  
-ç-o-o-u R-e-x-h-o-o , ç-o-o-u d-j-a-l-o-o !  
-j-o-o-o, p-o-o-o !**

## **THE BRIDEGROOM \***

**there comes the bridal party at the foot of the mountain**

**two villagers climb up the hillside  
why do they hurry so much?  
they're looking for the chestnut tree \*  
and silently they dig a grave  
neither shallow nor deep  
not for elderly mother, who cheated death a long time ago  
but for the only son  
that is sealing tomorrow in sorrow  
and she is still alive after all to cry  
rise up, Rexha\*, rise up, my boy  
no, yes!**

---

**\* Bridegroom is a symbol of a young person who struggles for freedom, often laying his life on the altar of the motherland's liberty.**

**\* Chestnut tree is usually used for a coffin.**

**\* Rexha is a young man in an Albanian popular elegy who is fatally struck by a horse. He embodies the bad luck that Albanians frequently experienced during their history.**

**( written 1981)**

## **SHQIPËRIA**

**Shqipëria ka male e fusha  
lumenj e dete...  
por, ajo ka diç  
që pak kush e di  
i ka edhe shtatëmilionë zemra  
të ruajtura në fishekzaret e mordjes  
për të pabesin  
për të pashpirtin  
armik**

## **ALBANIA**

**Albania has mountains and plains  
rivers and oceans  
but it also has something  
few know about  
it also has seven million hearts  
saved by the fireworks of death  
for the unfaithful  
for the heartless  
the enemy**

## **KOSOVËS**

**në bri të dhisë të kanë ngujuar  
e po t'i rrënojnë kullat e tua në zë  
të bukekripës në sofër të mikut  
dyerhapurat natë e ditë**

**oh! si po çirren të dehur  
mbi kokën tënde shamizezë  
e po pështyjnë horras  
mbi fytyrën tënde nusërore  
bajlozi i zi po trand male e fusha  
me thundrat e hekurta  
mbi trupin tënd, Kosovë!**

**hiç dhembje s'po kanë  
këto jokrijesa të këtij Parashekulli  
gjallimit tënd po ia numërojnë  
orët  
minutat  
sekondat**

**po ti s'vdes dot  
thonë, engjëlli nuk jep shpirt  
ai deri në amshim duron  
deri në rilindje të Gjergj Elez Alisë  
me shtatëqind plagë të marra në trup  
ndër mote**



## **TO KOSOVA**

**they have ensnared you at the brink of the abyss  
and now they are destroying your stone towers  
known for their bread salt and heart for the guest  
and opened doors night and day**

**oh! how they are screaming in their drunkenness  
over your black kerchief covered head  
and those villains they are spitting shamelessly  
in your innocent bridal face  
an evil Bajloz\* tramples over mountains and valleys  
he tramples with iron heels  
on your body, Kosova!**

**they feel no compassion  
these monsters from a bygone century  
they sit and count your life's last  
hours  
minutes  
seconds**

**but you cannot die  
they say an angel does not lose its spirit  
it endures into eternity  
until Gjergj Elez Alia is reborn \*  
with the seven hundred wounds he received to his body  
through the course of time**

---

**\*Gjergj Elez Alia is an Albanian legendary hero, who, although wounded and ailing, when challenged by an evil Bajloz (mythological figure), gathers strength and defeats him, thus defending his sister's and his homeland's honor. ( written 1981)**

## **S'PASKA ZOT, AS PERËNDI**

**nuk paska shenjtëri  
as profet madje, as Zot as Perëndi!  
koka po u dhemb shkronjave  
nga emrat Krisht, Muhamet, Marks,  
nga fjalët hyjni, barazi, të drejta njerëzore...**

**mbi abetaren time të lidhur në pranga  
hije po bën drapënçekani i Lenin-Stalinit  
përmendorja e Lirisë së Nju Jorkut  
dega e ullirit në sqep të pëllumbit të OKB-së  
fjala paqe e shkruar me germa të mëdha  
mbi qefinin e bardhë të fisit tim  
fatzi**

**im bir hipur mbi kullën e Dukagjinit  
zëshëm po çirret, o Zot, ku je?  
po bythecët me kundërmim pomade  
në pallatet e akulllandit  
të OSBE-së, OKB-së, BE-në  
në Gjenevë, Nju York, Strasburg, Hagë...  
thirrjen e tim biri  
sipas pentagramave me nota londineze  
e pagëzokan me nofkën  
blasfemi!?**

**s'paska Zot, as Perëndi!**

## **THERE IS NO LORD, NO GOD**

**there are no saints  
no prophet, no Lord nor God  
the letters have headaches  
from names like Christ, Mohammad, Marx  
from words like divinity, equality, human rights**

**over my handcuffed ABC book  
falls a shadow from Lenin-Stalin's hammer and sickle  
from the Statue of Liberty in New York  
from the olive branch in the beak of the UN dove  
from the word peace written in capital letters  
on the white shroud  
of my kinsfolk's dark fortune**

**my son cries out loudly  
from the top of the stone tower in Dukagjini \*  
God, where are you?  
but the pomade scented fools  
of the ice-hearted palaces of the OSCE, UN and EU  
in Geneva, New York, Strasbourg, and The Hague  
in accordance with the pentagram of the London treaty \*  
and my son's cry  
they baptize 'blasphemy'**

**there is no Lord, no God**

---

**\*Dukagjini is Kosova's western part.**

**\*The London Conference (1912-13) tragically dismembered  
Albanian territories, leaving more than half of Albanian lands  
and population under Serbia, Montenegro, Macedonian  
and Greece. ( written 1993)**

## **ARMIQTË**

**ju ka ndërsyer lakmia  
ndaj gjinjve vashërorë të fushave tona  
ndaj shtatit belhollë të pyjeve tona  
ndaj zemrës sonë të madhe  
gatuar me  
bukë e  
kripë**

**armiq, ne do t'ua lëmë të gjitha  
hithrat florë e faunë  
urat në bel të këputura  
mnelat e ecjes sonë përpara  
varret pa emër e histori  
as zog  
as korb**

**e do t'u godasin  
rrufetë e urrejtjeve tona  
shiu  
bora  
tërmetet  
sëmundja metuzalem**

**ciklopi i pendimit do t'u kafshojë  
me nofullat e veta vigane  
pastaj ju do të komandoni-prapaktheu!  
por, kthim s'do të keni  
sepse, toka jonë  
do të bëhet varri juaj**

## **THE ENEMIES**

**you have been seized by greed  
to embrace the soft bosom of our fields  
to grab hold of the thin waists of our forests  
to capture our hearts  
made of the bread and salt of hospitality!**

**enemies, from us you will receive  
only brambles and bile our flora and fauna  
bridges cut in half  
the remains we have left behind  
graves without names or histories  
no birds, no ravens**

**and you will be struck  
by the lightning of our rage  
by the rain  
the snow  
the earthquakes  
and Methuselah's curse\***

**the Cyclops of remorse will bite you  
with its enormous jaws  
then you will give the order: retreat!  
but there will be no turning back  
because our land  
will be your grave**

---

**\*Biblical illnes.**

**( written 1981)**

## **VALLJA DYSHE E SHEKULLIT XXI**

**varret e strëgjyshërve po m'i rrëmoni  
nëpër skica, projekte, eleborate...  
emrin tim po e lakoni  
sipas rasave, vetave e gjinive  
të gjuhëve të huaja, kentum e satem**

**nëpër kasafortat e kancelarive  
të Hagës, Brukselit, Gjenevës, Londrës  
tokës sime po ia vizatoni  
qiellin pa yje e pa diell**

**titërrimin e hënës mbi Dukagjinin engjëllor  
po e mbuloni me luftën polare  
e nipit tim të lidhur në shpërgenj  
ninullat mortore po ia këndon**

**në liturigjtë mbajtur në tempujt tuaj modernë  
orvelliançe vdekjen time ringjallje po e pagëzoni  
kryqe e sakramente sllave  
te kasolla ime po rrapëlljnë**

**por unë gjallë se gjallë  
herë ilirisht  
herë arbërisht  
në skenën e shekullit XXI do të hyj  
me vallen dyshe  
të luajtur shqiptarçe**

## **TWENTY-FIRST CENTURY DANCE**

**you ravage the graves of my ancestors  
to the letter of your sketches, projects, and investigations  
you use and abuse my name  
according to the case, person, and gender  
of foreign languages**

**in the government vaults  
in The Hague, Brussels, Geneva, and London  
you are drawing the sky of my land  
void of stars and sun**

**the moonlight over Dukagjini's sacred ground  
you hide behind the polar war  
and to my nephew, an infant in his mother's arms  
you sing morbid lullabies**

**in the liturgies held in your modern temples  
in Orwellian style you are baptizing my death as a rebirth  
Slavic crosses and sacraments  
rattle around my hut**

**but i live on  
in the Illyrian way \*  
in the Albanian style  
on the stage of the 21st century I come forth  
in a dance for two \*  
danced the Albanian way**

---

**\*Illyrians are the (ancient) ancestors of the Albanians**

**\*Albanians of Albania and Kosova will be able to dance together in  
freedom.**

**( written 1992 )**

## **DO TË NGRIHEMI SËRISH**

**ne do të ngrihemi sërish  
mbi gërmadhat e ëndrrave tuaja  
demoniake**

**mllëfit tuaj katil  
dhemb e dhëmballë do t'ia nxjerrim  
le të ngordhë urie  
te porta e Shekullit të Ri  
përtej Gurit të Shpuar**

**lakminë tuaj aziate  
në gropë coffinash do ta varrosim  
as korbata  
as hienat  
të mos e gjejnë dot**

**ne do të ngrihemi sërish  
mbi plagët e brishta të kufomave tona  
mbi muranat e lashta të eshtrave ilirikë**



## **WE WILL RISE AGAIN**

**we will rise again  
over the ruins  
of your diabolic dreams**

**we will pull out the teeth  
of your ruthless rage  
let it die of starvation  
at the gate of the new century  
beyond the drilled-through stone \***

**your vast continental greed,  
we will bury in the carrion pit  
and neither ravens  
nor hyenas  
will be able to find it**

**we will rise again  
in spite of the sore wounds of our tortured bodies  
over the ruins of the ancient Illyrians**

---

**\*The natural border between the Slavonic and Albanian settlements.**

**( written 1993)**

## **EMRI IM I PAVDIRË**

**Ilahtarshëm po pëllet urrejtja pranë kasolles sime  
u thinje me durimin urtak në parzëm  
o populli im! Robinson Kruzo në ishullin e Evropës  
Miss Universum i Aparteidit  
zgjedhur në lozhat e masonëve  
të të dhjamosurve senilë**

**përbindëshi i makthit po ta kafshon lavdinë  
në varre heronjtë e fisit mornica të ftohta po i kaplojnë  
o populli im, ndërgjegje e mjegullt e Evropës  
Miss Universum i Robërisë  
zgjedhur nga jashtëqitja trunore  
e fundshekullit XX**

**o populli im i pavdirë!**

## **MY NAME WILL NOT DIE**

**while hate howls gruesomely at my hut  
you have grown old with wise patience in your heart  
oh my people! you are Robinson Crusoe on the island of Europe  
you are Miss Universe in Apartheid\*  
chosen in the Mason lodges  
by senile fat slobs**

**the demons of nightmares bite at your glory  
the heroes of our nation tremble in their graves  
oh my people, Europe's muddled conscience  
Miss Universe of bondage  
chosen by the twentieth century  
cerebral weaklings**

**oh, my immortal people!**

---

**\* During 1989-1999 Kosova was the biggest Apartheit in Europa.**

**( written 1993)**

## **KOPILAT E ADAMIT**

**nga Albakosburgu i Evropës së Jugut \*  
orë e çast mbushen përplot  
autobusë, trena, avionë, anije...  
ia mësyjnë kristofor kolombot modernë  
reth e përqark globit tokësor  
gjakojnë zbulimin e kontinentit të panjohur  
të azillandit**

**në këtë udhëtim të pafund  
gratë shtatzëna lindin  
hapësirave pa juridiksion shtetëror  
çertifikatat e fëmijëve të tyre  
në vend të rubrikës "Qyteti", "Shteti"  
kanë të shënuar korridorin fluturues  
apo shkallën e navigacionit  
dhe emrin e nunit të panjohur  
kapitenit të ekuipazhit**

**nëpër aeroporte, stacione trenash, porte detare...  
në Evropë, Amerikë, Australi...  
gjuhë e dytë është bërë ilirishtja e re**

**e flasin mërgimtarët  
pa të drejtë kthimi në vendlindje  
mysafirët e tyre  
halabakët  
dashnoret e tyre  
burrat pleq  
gratë analfabete  
fëmijët, pa çerdhe fëmijësh**

**ilirishtja bukolike  
në vetmi i bie fyellit të vet baritor  
rrokaqijeve marramendës të metropoleve  
të botës së  
hiçit**

**kopilat e Adamit  
dhe të Ev(rop)ës kurvë  
të mohuar  
dje  
edhe sot?**

## **ADAM'S STEPCHILD**

**from the Albakosburg in Southern Europe  
comes the steady stream  
of overcrowded buses, trains, airplanes, and boats  
today's Christopher Columbuses  
go ahead all around the globe  
thirsty to discover the unknown continent  
of the promised land**

**during this endless journey  
pregnant women give birth  
in areas without state jurisdiction  
birth certificates don't mention city or country of birth  
only the longitude and latitude of the plane's position  
and the child's unknown godfather  
is the captain of the flight**

**in airports, train stations, and sea and ocean harbours  
in Europe, America, and Australia  
Neo-Illyrian\* has become a second language**

**and there the immigrants  
without the right to return home  
their guests  
hooligans  
their mistresses  
the old men  
the illiterate women  
children that have never seen a preschool  
speak**

**the bucolic Illyrian speech  
that sounds like a singular melody of the pastoral flute  
between the immense skyscrapers of the metropolis  
in the world of emptiness**

**Adam's stepchildren  
and left to the harlot Europé  
denied  
yesterday  
and even today!?**

---

**\* During the period 1989-1999 more than half a million Kosova-Albanians emigrated to the west.**

**\* Albanian is the Neo-Illyrian language.**

**( written 1992 )**

## **DHUNIMI I SHËN PAQES VIRGJËR**

maramenti duke u sjellë rreth natëditës së vet  
shekulli plak në prag të vdekjes  
mendueshëm e mban kokën me dy duar, dhe  
dëgjoka fjalën e shenjtë paqe  
nga lahutari i verbër homerian  
nga i drejti Hamurab, luftëtari Atila  
faraonsulltani, Hitler-Stalini  
kryerrenci botëror Bush-Jelcini  
lexoka në Bibël e Kuran  
në Kartën e Ligës së Popujve dhe të O K B-së  
në rezoluta e nota diplomatike  
në marrëveshje të fshehta e publike  
në pakte e traktate...  
por, Shën Paqen askush s'e pa mbi dhe!?

në fundjetën e shekullit plak  
globin e pakunguar e kanë zënë ethet  
popujt këmbëzbathur po ikin  
nga gojëdhënat, përrallat...  
dhe po trokasin dyerve të përgjakura të historisë  
hapeni! jemi ne, abortët e paqes suaj  
të Rendit të Ri Botëror  
ne, fëmijët e durimit thinjosh  
bonjakët e flijuar pamëshirshëm  
në hartat gjeografike të Stalin-Çerçil-Rusveltit  
në Jaltë, Postdam, Maltë...  
zotërinj! të qetë s'do t'u lëmë kurrë  
zjarrin makbethian prore do t'ua ndezim  
bordeleve të Moskës, Parisit, Londrës, Vashingtonit  
juve, që mynxyrshëm e dhunuat Shën Paqen Virgjër  
ndjestë pastë!



## **THE RAPE OF THE GODDESS OF PEACE**

**dazed, the old century wanders around  
through the light of day and fog of night  
on the threshold of death  
he sits pensively with his head in his hands  
and hears of the holy word Peace  
spoken of by the blind Homer-like minstrel  
by the law's sentry Hammurabi, by the conqueror Atilla  
by pharaohs, sultans, by Hitler and Stalin  
by the giant liars Bush and Yeltsin  
it is written about peace in the Bible and Koran  
in the treaties and UN's charter  
in resolutions and diplomatic notes  
in secret and public pacts  
but not once has the Goddess of Peace  
shown herself on this earth**

**while the old century breathes his last breath  
the world spins feverishly and anxiously  
the people barefoot  
leave the legends and fairytales behind them  
and knock on history's blood-sullied gates  
open! It is we that are silenced  
when your peace has a miscarriage  
in the New World Order!  
it is we that have grown old waiting patiently  
we orphans, who were mercilessly sacrificed  
from Stalin, Churchill, and Roosevelt's maps  
in Yalta, Potsdam, Malta  
gentlemen! we will never leave you in peace  
we will light a fire that will consume  
the brothels in Moscow, Paris, London and Washington  
together with you, who violated and destroyed  
the Goddess of Peace  
may she rest in peace**

**( written 1992)**

## **KASHË E LASHË**

**shpallje!**

**shpallen të hapura garat në shkallë kombëtare**

**nënat duhet të lindin sa më shumë fëmijë**

**për t'i plotësuar normat**

**e qelive sapo të ndërtuara**

**në Nish, Burrel, Idrizovë, Spaç...**

**këtu do të bëhet shkollimi makabër i njerëznumrave**

**sipas abecesë animaliste të Darvinit**

**në mbështetje të mësimëve tepër të shtrenjta**

**të të pavdekshmit faraon ballkanikusit, Tito-Enverit**

**përshtetjet revolucionare**

**Partia!**

**PS:**

**Tepër sekret! Nëna kini kujdes ndaj armikut klasor!**

## **THE RIDDLE**

**attention**

**we hereby announce open national competition  
mothers are challenged to give birth to the highest number of  
children**

**in order to fill the norm**

**in the cells that have just been completed**

**in Nis\*, Burrel\*, Idrizova\* and Spac\***

**a macabre number of people will be educated**

**according to Darwin's animalistic ABC**

**and based on the dearest teachings**

**of the the eternal Pharaoh Balcanicus, Tito-Enver**

**with revolutionary greetings**

**The Party!**

**P.S. Top secret! Mothers: be very cautious of the class enemy!**

---

**\*Infamous prisons of the former Yugoslavia and Albania during  
the Communistic era.**

**( written 1991)**

## **LAJMET**

**ju flet Radio Komunizmi  
po i japim lajmet  
sot, pikërisht në orën 12,30, në kuotën 104  
me pjata fluturse arritën qeniet jotokësore  
ata lanë porosinë interplanetare -  
edhe ne i bashkangjitemi kërkesës gjithëpopullore  
që shoku Parti të emërohet Udhëheqës  
pa kufizim mandati  
për gjithë kozmosin  
kurse Zoti, si mbeturinë e ndyrë klasore,  
të shkarkohet menjëherë nga froni  
kërkesa në Byro u miratua me aklamacion  
Tito-Partia! Parti-Enver!**

**Zoti u trishtua nga hija e vet**

## **NEWS**

**this is Radio Communism  
we report the news  
today, at exactly 12:30, at grid 104  
extraterrestrials with flying saucers landed  
they left the following interplanetary message:  
even we stand unanimously with the public demand  
that comrade Party be named leader  
with an unlimited mandate  
over the whole cosmos  
whereby God, society's dirty relic  
be immediately removed from the throne  
this demand is accepted by the political bureau acclamation  
Tito-Party! Party-Enver!**

**God was saddened by his own shadow**

**( written 1991 )**

## **KOSOVARI I MËRGUAR**

**e mori kosovari valixhen  
tre fëmijët e vet  
dhe u nis drejt Veriut**

**majtas ishte gremina,  
djathtas qe ngrahina e Agata Kristit  
prapa mynxyra e Drenasit të kësikohshëm \***

**sapo zbriti në tokën e Premtuar  
fëmijët e gjeten kutinë e Pandorës  
dhe u mrekulluan**

**kosovari ngeli fill i vetem  
veç me Kosovën e tij  
në ëndrra**

---

**\* Kjo poezi u shkrua më 1991, kur në Drenas policia serbe  
i detyronte shqiptarët të hanë bar !!!**

## **KOSOVARS IN EXILE**

**the Kosovar\* Albanian grabbed his suitcase  
took his three children by the hand  
and traveled to the Nordic countries**

**to the left an abyss  
to the right Agatha Christie's edifice  
behind him the misery in Drenas\***

**as he stepped down on the promised land  
the children found Pandora's box  
and were astonished**

**the Kosovar stood there alone  
with the image of Kosova  
in his dreams**

---

**\*Kosovar is a term denoting Albanian people of Kosova.**

**\*The year this poem was written, the Serbian police in Drenas,  
Kosova, hand-forced Albanians to eat grass!!!**

**( written 1991)**

## **DITË VERE NË DUKAGJIN**

**me govata uji në dorë  
engjëjt i shpërlanë xhamat e qiellit  
sa çil e mbyll sytë iu duk kërthiza vashërore  
kaltërimit**

**nallbani plak te lëmi i drunjve  
diellit ia mbathi patkonjtë me thumba rrezesh  
le të kalërojë, tha ai, horizonteve të pafund  
të Dukagjinit përrallor**

**tani hapekrah portat i çeli mëngjesi  
faqekuqe po hyn dita  
nusëruar me duvakun  
veror**

**pas pak trishtueshëm filluan të biejnë këmbanat e vapës  
mesditës i ra të fikët  
e demi i etjes po pëllet i harlisur  
shkumë për goje duke qitur**



**pasdite nisi t'i shterojë edhe gjiri  
nuses së murosur tek Ura e Fshejt  
gurë e drurë po i tundon vaji i kërthinit  
të cilin legjenda tashmë s'e mëkon dot**

**lart, në qiell drapri anemik i hënës  
e përgjëron farkëtarin e natës për pak gjak  
por, ai degdisur përtej Alpeve Shqiptare  
kotet**

**dikujt iu kujtuan falltoret evgjite  
ato në shuplaka dore i panë duke rendur  
krushqit e rinj, hipur mbi kuaj të reve  
shiun stolisur me ylber krahaqafë**

**më vonë, disa të halitur Zotit i fishkëlluan në vesh  
ai u tremb, nxitueshëm i lëshoi perdet e territ...  
ja, tani yjet e përgjumur po i fërkojnë sytë  
mbi Dukagjin**

## **A SUMMER DAY IN DUKAGJINI\***

**with water pails in hand  
the angels washed heaven's window  
for an instant the azure blue  
showed its navel like a virgin girl**

**the old blacksmith shod the sun  
with rays like those out on the cutting fields  
let it shine, he said, in the infinite horizons  
in Dukagjini's fairy tale world**

**now the morning opened its gates wide  
and blushing the day stepped in  
a bride wrapped  
in summer's veil**

**later the bells of heat started to clang  
the midday fainted  
and the bull of thirst bellowed wildly  
with foam pouring from its mouth**

in the afternoon the breast milk  
of the young woman bricked in the Holy Bridge\* started to dry up  
stones and trees shook from the infant's cry  
whom the legend can no longer nourish

high above the sallow crescent moon implores  
the night's blacksmith for a little blood  
but he is dozing beyond the Albanian Alps\*  
where he was banished

someone remembered the Gypsy fortune tellers  
who could see in the open palm  
how the young escorts of a wedding party came riding  
on the backs of clouds  
bejewelled with rainbows around the neck

later came a few rascals and whistled in God's ear  
he became startled and quickly dropped the curtain of darkness  
now the sleepy stars rub their eyes  
over Dukagjini

---

\*The outer-west part of Kosova.

\* An echo of the the ballad of immurement widely occurring in the  
Balkan's legends and folk culture.

\*The eastern part of Kosova.

## **LEKTISJE E PASHUAR**

**e bërë kruspull këmbë e krye  
hëna u rras nën jorganin e trashë të reve  
tash një vezullim paqësor  
i varet në qepalla**

**diku, përtej gjakimit fanitës  
natën kalldrëmeve të Dukagjinit  
trokun e gjokut të Ago Ymerit  
nusevejat e ëndërrojnë...**

**err e terr pranë kroit  
një nënë e verbuar nga rapsodi i baladës  
pret e përcjell kalimtarë buzëfshikur  
tim bir a s'ma patë?**

**i zënë rob nga nanurisja e përrallave hirplota  
ai kulmos çatinë e Sizifit  
derëzi**

## **UNQUENCHABLE LONGING**

**curled in a fetal position  
the moon pushed its way under the thick blanket of clouds  
a tranquil glitter now hangs  
on the moon's eyelashes**

**somewhere, beyond the apparition of longing  
young widows\* dream  
the nightly echoes of Ago Ymeri's horse's hoofbeat  
on the cobblestones of Dukagjini\***

**From dawn to dusk  
A mother, blinded by the minstrel's ballad  
Waits and follows after travellers desperately asking  
have you perchance seen my son?**

**mesmerized by the gentle soothing beauty of fairytales  
and lullabies  
he builds a roof for ill-fated Sisyphus\***

---

**\* "Ago Ymeri" is a character of old Albanian ballads: He was taken captive in a foreign land; his wife remarried, and his mother became blind while waiting in vain for her son's return.**

**\* "Young widows" are Albanian women left unmarried either as a result of massive emigration of the male populace of Kosova or as a consequence of war.**

**\*Sisyphuss work = meaningless work.**

**( written 1993)**

**FOLE E DHEMBJES SË BUKUR  
THE ABODE OF SWEET PAIN**

## **FRYMËZIMI**

**ti je ai qumështi vesor  
që ia shëron trëndafilin rrufën**

**ti je ajo aroma fanitëse  
pas së cilës luleve u bie të fikët**

**ti je ajo ninulla dukagjinçe  
që e vë në gjumë mllefin katil**

**ti je ajo dritëhëna vezulluese  
që ua ndriçon shtigjet e errëta baladave**

**ti je ai duvaku i rrezeve  
që e nusëron prillin**

**ti je ajo shoka e ylbertë  
që ia lidh ijet vjeshtës reumatike**

**ti je ai kaltërimi veror  
që e grish hënën të dalë lakuriq**

**ti je ai frymëzimi i hirtë  
që mbëlton yje në kopshte poezie**

**ti je ai, që hyn në zemër njëherë  
dhe, s'del kurrë më**

## **INSPIRATION**

**you are the milky dew  
that cures the rose's malady**

**you are the intoxicating scent  
that makes flowers faint**

**you are the lullaby from Dukagjini  
that calms the evil fury's rage**

**you are the glowing full moon  
that illuminates the ballad's dark paths**

**you are the weave of sunlight  
that makes April bloom**

**you are the rainbow's belt  
fastened around autumn's rheumatic hips**

**you are summer's azure hue  
that invites the moon to come forward nude**

**you are the graceful spirit  
that plants stars in poetry's garden**

**you are the one who once entered my heart  
and will never leave it**



## **POEZI BIBLIKE**

**prej hiçit të fjalës sime  
dua të krijoj bukurinë biblike  
Even-Doruntinë**

**ia filloj me pak tokë e  
lule  
me pak shi e  
ylber  
me pak dritë e  
ëndrra**

**por, o Zot! sa e pakapshme qenka  
përsosmëria jote**

## **BIBLE POETRY**

**from my word's vanity  
I want to create biblical beauty  
my Eve-my Doruntina**

**I start with a handful of earth and  
flowers  
with a little rain and  
a rainbow  
with a pinch of light and  
dreams**

**but, my God, the perfection of your work  
is unfathomable**

## **KRYEVEPRA E ZOTIT**

**ç'bënte Zoti kur po lindej Doruntina?  
në pikë të hallit paskësh rënë  
si ta ringjallë vetveten edhe njëherë  
e të mos jetë më as Zot  
as Krisht  
as profet  
gjakonte për të lënë kryeveprën e vet jetësore**

**mendoj, çmendoj, Pikason e thirri në ndihmë  
po, djallopunë,  
piktura iu duk tepër abstrakte**

**veçse, Zoti rastësisht nuk është Zot  
ai gjithçka në dorë të vet e ka  
urdhëroi-të lindet vasha me emrin Doruntinë  
e të jetë më e bukur se ajo nga Kënga mbi Këngët  
e të ketë devotshmëri biblike  
dhe, marrëzisht ta dashurojë poeti**

**pikë për pikë ashtu u bë  
tani, Zoti plak me monokël në sy  
e shikon i mahnitur kryeveprën e vet madhore  
Doruntinën  
në Gatnik**

## **GOD'S MASTERPIECE**

**what was God doing when Doruntina\* was born?  
he found himself greatly confused  
How should he revitalize himself  
and not be God any longer  
or Christ  
or prophet  
he longed to create his true masterpiece**

**he thought and thought. At last he called  
Picasso to help. Damn it!  
the painting was much too abstract**

**but God isn't God for nothing  
he holds everything in his hand  
he decided that a girl with the name Doruntina should be born  
and that she would be more beautiful than**

**The Song of Song's virgin**

**with biblical devotion  
and that the poet would love her madly**

**and so it was, to the last detail  
now the old God peers through his monocle  
amazed by his completed masterpiece  
Doruntina  
In Gatniki\***

---

**\*Doruntina: Albanian female character from the ballad " Costandine and Doruntine" used frequently in this poet's work as a symbol of beauty, purity and the transcendental power of a sacred word or (sacred) promise.**

**\*Gatniki = the village where Doruntina was born.**

## **HYN GJARPËRI E DEL NUSE SHTATSELVI**

**nëse ka diçka në këtë botë  
që s'mund të përshkruhet kurrë  
ajo është bukuria jote**

**sytë e tu po të mos ishin  
agimi do të lindte i verbër  
e hëna kurrë s'do ta kish atë ngjyrë portokalli**

**nëpër unazën magjike të bukurisë sate  
hyn terri e del dritë e bardhë  
hyn shiu e del ylber i mrekullueshëm  
hyn rrezja e del buqetë trëndafilash  
hyn meteoriti e del yll polar  
hyn pikëllimi e del gëzim i harlisur  
hyn urrejtja e del zemërbardhë si dashuria  
hyn gjarpri e del nuse shtatselvi**

**pse thonë se në botë janë veç shtatë mrekulli?  
të tetën dhe më të bukurën e ka parë veç një poet  
tani i çmendur**

## **THROUGH THE MAGIC RING OF YOUR BEAUTY**

**if there is anything on this Earth  
that cannot be described  
it is your beauty**

**if your eyes didn't exist  
the dawn would be born blind  
and the moon would never ripen to orange**

**through the magic ring of your beauty  
dark enters and becomes a blinding light  
rain enters and becomes a beautiful rainbow  
a sunbeam enters and becomes a bouquet of roses  
a meteor enters and becomes the North Star  
sorrow enters and becomes overwhelming joy  
hate enters and becomes loving kindness  
the snake enters and becomes a beautiful bride**

**why is it said that there are seven wonders in the world?  
the eighth and the most beautiful only a poet has seen  
now already entranced**

## **NJË LLOJ DRITE TJETËR**

**edhe njëherë i lexova poezitë e mia për ty  
befas më ra në sy se  
për së tepërmi i përmendkam yjet, diellin, hënën, ylberin  
(mbase jam frikësuar  
mos, vallë, brenda vargjeve të mia po të kaplon një hije terri!)  
sonete, në këtë poezi, s'do t'i përmend këto  
do ta gjej një lloj drite tjetër, të panjohur deri më tani  
që të llamburisë mbi këto udhë të gjata rreshtash  
gurë s'do të lë pa lëvizur, këtë dritë për ta gjetur  
po, vallë, si do ta gjejë unë, poeti?  
po më duket se rrugëdalje tjetër s'më ka mbetur  
veçse n'e marrsha emrin tënd  
Doruntinë**

## **ANOTHER TYPE OF LIGHT**

**again I read my poems to you  
and I suddenly noticed  
that I idyllically name the stars, the sun, the moon, the rainbow  
(maybe I was afraid  
that a dark shadow would creep in between my lines?)  
now this evening I will not speak of these things anymore  
I will find another type of light, as yet unknown  
that will give my verses' long passages a beautiful shine  
no stone will be left unturned, I will search tirelessly  
to find this light  
but how will I, as a poet, find it?  
at last I realize there is no other way  
except to embrace the light of your name  
Doruntina**



## **AGON NË ËNDRRA**

**nuk është dashuri ajo  
nëse çdo natë ti nuk agon në ëndrra**

**nëse në labirintet më të shurdhëta të ndërdies  
nuk jehon prore zëri i largët i thirrjeve të tua**

**nëse pareshtur portreti yt  
nuk parakalon madhështor para tribunës së fantazisë**

**nëse mushkëritë e frymëzimit  
nuk frymojnë veç hirësinë tënde**

**nëse malli im për ty  
nuk ua ndal rritën mendimeve të tjera**

**nëse pikëllimin e pangushëlluar  
nuk e shëron kujtimi yt**

## **DAWN OF MY DREAMS**

**it is not true love  
if every night you don't appear as a dawn in my dream**

**if the hidden mazes of consciousness aren't  
constantly filled with the echo of your voice**

**if your figure doesn't endlessly  
float along the shores of my fantasy**

**if the lungs of inspiration don't  
inhale only your sweet scent**

**if my tenderness for you can't ?  
prevent other thoughts from growing**

**if my incurable pain can't  
keep the memory of you alive**

## KALTËRON DET E QIELL

gjarpri i zi i vdekjes  
para teje vallëzon në majë të gishtërinjve, si balerinë  
harruar i ka të vegjëlit e vet të uritur në fole  
se më, mos o Zot!, të kafshojë ndokë  
hutuar e paskësh fyelli magjik i bukurisë sate -  
kraharori yt-hënë mes resh  
që prore e grish ujëvaren e epshit

sytë e tu kur shikojnë  
kaltërojnë det e qiell të turbullt  
yjeve u merren mendtë, pikojnë në prehrin tënd  
e i zë gjumi në pikë të ditës  
krojeve u thahet qiellza për një pikë ujë  
e bëjnë që memecët të ligjërojnë  
oratorëve t'u merret goja  
besfortëve jetikë t'u thyhen prangat e besës

ai që të ka parë qoftë dhe veç një herë  
vdes syhapur po s'të pa më  
ashtin s'ia kalb dot dheu

## **BLUE SEA BLUE HEAVEN**

**the black snake of death  
dances on its pointed tail like a ballerina in front of you  
she has forgotten her children starving in the hole  
and God willing, she will never again bite someone  
she is charmed by the magic flute of your beauty  
your breasts-the moon between clouds  
brings forth a constant torrent of desire**

**The gaze of your eyes  
turns the foggy sea and gloomy sky blue  
the stars become dizzy, they fall in your lap  
they sleep in the middle of the day  
and the well's mouth is thirsty for a drop of water  
even the deaf-mute regain their speech  
and the orators are rendered speechless  
when they see your eyes  
the chains of the sacred pledge are broken**

**he who has seen you once and never more  
dies with open eyes  
and the soil does not rot away his bones**

## **ASKUND S'TË LËNË TË QETË**

**në planetet e tjera janë kurdisur plane të fshehta të të grabisin  
të shëmtuarit! duan ta fisnikërojnë racën e tyre të çoroditur  
gjysmëhëna skuqet, ul kokën e hidhëruar  
pse s'mund të lindë prore e plotë si ti  
qielli me ylberin e vjedhur të bukurisë sate  
ia lidh kordelet shiut flokëshprishur**

**në tokë, luleve iu pëlçet mëshikëza prej xhelozisë  
pse ato s'mund të zbukurohen si ti  
zogjve shkumë për goje u shkoka  
meqë aspak zërit tënd s'mund t'i gjasojnë  
piktorit i dridhet brusha në dorë  
kur portretin tënd e fillon**

**o, të gjithave ti ua paske marrë pahin!  
e, pra, jo Tanusha e kralit të Kotorrit  
por vasha e trëndafiltë, Doruntinë**



## **SYTË E TU**

**janë fole rrezesh  
yjeve ua ndezin dritat  
portë enigmatike  
ku lehtë mund të hyhet, por assesi të dilet**

**kur shikojnë  
lumenjtë zënë në thua, thyejnë qafën  
lisat e gjatë marrin qëndrimin-gatitu!  
Shën Mërisë i bie prej duarve në tokë Krishti i Vogël**

**kur buzëqeshin  
ndërtojnë ura të ylberta prej zemre në zemër  
ua shërojnë plagët luleve  
janë varr i pikëllimit**

**kur vajtojnë  
blerimi venitet  
sëmuren ylberët  
gjarpri i barnatores e kafshon në dorë Hygien**

**kur mbyllen  
dy hënëza në gjumin qiellor  
që ëndërrojnë përjetësinë**

## **YOUR EYES**

**they are a bouquet of beams  
that light the starlight  
the mysterious door  
that one easily enters but never exits**

**when they look out over the world  
the rivers alter their course, at breakneck speed,  
the tall oaks stand at attention  
and the newborn Christ falls out of Mary's hands**

**when they smile  
rainbows build bridges from heart to heart  
the sores of flowers are healed  
they bring the end of grief**

**when they cry  
the greenery wilts and fades  
the rainbows fall ill  
the snake bites Hygieia's hand**

**and when they close  
they are two crescent moons  
that dream of immortality**



## LETRA

duhet hapur me magji  
të mos tremben gjithë ato që as nuk shihen, as nuk preken  
tajfuni i shqetësimeve që rrah brigjet e aortave  
vrapimi maratonik i gjakut  
aritmia e zemrës  
frymëmarrja që s'ngopet dot frymë

medet! magjia aspak nuk ndihmoi  
gjumin e goditi sëmundja e pagjumësisë  
rrëmujë përfytyrimesh  
tinguj të çoroditur mendimesh  
durimi u nevikos pamasë  
lakuriq, si i çmendur, vrapon rrugëve të qytetit

ja, tani, ngadalë, orkestra e germave  
ekzekuton valset e buzëqeshjeve të tua  
orteku i ankthit ikën me të katra prej kraharorit  
gëzimi organizon olimpiadë  
kujtimeve të ngrira nga harresa  
u ngrohen eshtrat

## THE LETTER

magic is needed to open it  
so as not to scare those that are neither seen nor heard  
the hurricane of worry that thunders against the aorta's pulse  
the marathon race of blood  
heart arrhythmia  
shortness of breath

oh, magic didn't help at all  
sleep was stricken by insomnia  
by the chaos of fantasy  
and by the distorted sounds of thought  
patience, extremely nervous,  
like a lunatic, runs naked through the city streets

but now, slowly, slowly the alphabet's orchestra begins  
playing the waltz of your soft smile  
anxiety's avalanche is vaulted off the chest  
joy organizes the Olympics  
and the frozen memories  
warm up their bones

## **DITË VERE**

**disa molerë të pa zanatë  
natën e paskëshin lyer qiellin me bojë të zezë, futë  
të tmerruar pastaj, pa gjurmë qenkan tretur  
zor se do të zbardhëlojë ndonjëherë!**

**u dashka flijimi i vashërisë  
u gjet një vashë shpirtmirë e tha-Po!  
ja, tani, pa nunëri plakash qindravjeçare  
bardhësi tamblabore po lindë**

**mirëpo, siç po shihet, mëkat i madh qenka bërë  
ushujza e vapës sot pikën e gjakut s'po ua lë  
krojeve, lumenjve...  
madje, rrezik i madh është nga përmbytja apokaliptike  
Poli i Veriut dhe ai i Jugut të shkrihen tok  
ruana Zot!**

**o, ju, molerë të mrekullueshëm!  
ju lutem me përulësinë më të madhe  
kthehuni edhe njëherë!  
e lyeni veç një copë qiell mbi Gatnik, siç e lyet mbrëmë  
të mos m'i ndodh sot gjë e ligë  
Doruntinës**

## **SUMMER DAY**

**some sloppy painters  
painted heaven a coal black in the night  
then they fled, scared, without a trace  
how will it ever be light again?  
a girlhood sacrifice is needed  
a pure-hearted girl was found who said: yes!  
and look, without the godmotherhood of centenarian women  
a purity as white as milk and snow is born**

**but a great sin has been committed  
the heat's leeches suck out the last drops  
from wells and rivers  
there is even a big risk of the apocalyptic deluge  
that the North and South Poles would melt together  
God save us!**

**oh, you fantastic painters  
I humbly beseech you  
come back, just once  
and paint a little bit of heaven over Gatniki, like you did in the night  
so that no harm may happen to  
Doruntina**

## **NATË VERE**

**hëna ka veshur një fustan drite  
të kuq si epshi  
malet kanë rënë përmbys, po koten  
asgjë s'pipëtinë veç trokut të heshtjes  
gjithçka frymon qetësi të amshuar...  
po, vallë, në ç'pallate ëndrrash  
do të ketë hyrë sonte Doruntina?**

## **SUMMER NIGHT**

**the moon has donned an illuminated dress  
glowing red with passion  
the mountains have reclined and are dozing  
not a whisper is heard, just the drop of silence  
everything breathes eternal tranquility  
but I wonder, in what palaces of dreams  
has Doruntina gone tonight**

## **I DASHURUARI**

**ai kurrë s'është vetëm  
mikun më të mirë e ka kujtimin  
i kupton edhe gjërat, që të tjerët s'i kuptojnë dot  
i pëshpërit në vesh lules, peshkut, blerimit...  
lulëzon më bukur se vetë trëndafili  
eshtrat i ka të mbushura me ajr lumturie  
gjithësia është e vogël për fluturimin e tij të madh  
në qiell ka ndërtuar një fole të fshehtë  
ku i mbledh yjet si margaritarë  
gëzimi i tij ka ngyrë të ylbhtë  
ëndërron gjithmonë diçka të përkryer...  
veç zemrën kurrë mos ia kërkoni  
ajo ka herë rreh pranë zemrës tjetër**

## **THE INFATUATED**

**he is never alone  
his best friend is memory  
he understands things that others cannot understand  
he whispers in the ear of flowers, fish, and greenery  
he blooms more beautiful than the rose itself  
the bones in his body are filled with the air of happiness  
the universe is not big enough for his flight  
in heaven he has built a secret nest  
where he gathers stars like pearls  
his joy has the rainbow colors  
he always dreams about something perfect  
just never ask for his heart  
it already beats close to another one**



## **BRENDA NJË DITE**

**në agim të kërkoj  
ti fshihesh nën vesën e harrimit  
(si trëndafil i paçelur në mëngjes)**

**në mesditë të thërras  
ti shpërndaresh në hapësirën e pafund të dritës  
(si mllefi në zemër)**

**dikur, natën vonë  
e yllëzuar më hyn në ëndërr**

## **WITHIN A DAY**

**in the dawn I look for you  
(like an unopened rosebud)  
you hide in the faded memory of dew**

**at midday, I call for you  
(like a built-up rage)  
you become a part of the light's endless space**

**not until late at night  
do you climb in my dreams, you made of stars**

## **SHPIRT HYJNOR**

**veç unë e di pse ndrin kaq shumë kjo dashuri  
emri yt, Doruntinë, i jep shpirt hyjnor \*  
imi përjetësi**

---

**\* Emri Doruntina vjen nga greqishtja-Dorotea,  
dmth. dhuratë e Zotit.**

## **HEAVENLY SPIRIT**

**I alone know why this love shines so brightly  
your name, Doruntina \*, gives it heavenly spirit  
mine gives it the taste of eternity**

---

**\*Doruntina (Dorotea in Greek) means the gift of the God.**

## **EDHE MË E BUKUR NË ËNDRRA**

**papritmas ardhja jote s'mund të vinte më dot  
pikëllimi mori ngrën e limonit  
e, gjuha iu kthye atdheut të vet parahistorik, heshtjes  
o, po ti më qenke edhe më e bukur  
në ëndrra**

## **EVEN LOVELIER IN DREAMS**

**suddenly your arrival couldn't take place  
sorrow became the color of lemons  
and the tongue drew back to its prehistoric beginnings: silence  
but you are lovelier than ever  
even lovelier in dreams**

## **FOLE E DHEMBJES SË BUKUR**

**kthehu sërish në folenë tënde  
o dhembje e bukur!  
o dashuri mitare!**

**zemra ime është nuskë  
për ëndrrat hyjnore**

## **THE ABODE OF SWEET PAIN**

**return to your abode  
you sweet pain  
you innocent love**

**my heart is an amulet  
for divine dreams**



## **PA TITULL**

**hëna ka të ftohtë, po ngrin në kupën e qiellit  
ikën ajo vrap e struket mes rreshtave të poezisë sime  
pranë emrit tënd, Doruntinë, i ngrohet gjaku**

## **WITHOUT TITLE**

**the moon is cold and freezes under the dome of the sky  
it escapes, and huddles up amidst the verses of my poetry  
by your name, Doruntina, the moon's blood warms up**

## **NJËSOJ E BUKUR**

**më mirë që s'u takuam  
yjet së afërmi s'e kanë atë dritë farfuritëse  
hëna është më e bukur në qiell se në cilëndo poezi  
por, qoftë larg, qoftë afër  
veç ti ma paske  
të njëjtën bukuri**

## **JUST AS BEAUTIFUL**

**maybe its better that we didn't meet  
up close, the stars don't have that glistening light  
the moon is lovelier in the sky than in any poetry  
but you are the one  
who both up close and far away  
shows me the same beauty**

## **NJË DRITË QË S'FIKET KURRË**

**jam shumë i lodhur  
sytë po më dhembin nga pagjumësia  
duhet fjetur  
mbyll derën, shtrihem në shtrat  
një nga një po më fiken dritat e mendimeve  
po, një kurrsesi s'po më fiket  
kujtimi për Doruntinën**

## **A LIGHT THAT NEVER GOES OUT**

**I am very tired  
my eyes hurt from insomnia  
I must sleep  
close the door and lay on my bed  
the lights of thoughts go out one by one  
but there is one light that never goes out  
the memory of my Doruntina**

**NJË ZOG PRORE E VAJTON**

**A BIRD'S LAMENT**

## **ASGJË PREJ QIELLIT**

**dy duar të ngritura lart  
nuk e përshëndesin diellin që e ka varë qafën në perëndim**

**as hënën që po përgatitet për të marrë fronin qiellor  
ato, asgjë s'kërkojnë prej qiellit**

**dy duar të ngritura lart thonë diç  
që me gojë kurrsesi s'mund të thuhet**

**piktor, o piktor!  
kurrën e kurrës s'ke për ta ditur  
se ç'bojë ka pikëllimi njerëzor**



## **NOTHING OF HEAVEN**

**two hands that reach upward  
don't greet the sun hanging in the west**

**nor the moon getting ready to take the sky's throne  
they ask nothing of the sky**

**two hands that reach upward say something  
that a mouth can never speak**

**artist! artist!  
you will never ever be able to know  
the color of human sorrow**

## **XHELOZIA**

**kur ti e shikon qiellin  
sterrë me re u bëftë!**

**kur ti e shikon detin  
për ilaç ujë mos mbetë!**

**kur ti i shikon të tjerët  
vdekja më rri shumë afër**

## **JEALOUSY**

**when you look towards the sky  
let it be as black as ink**

**when you look at the sea  
let it be as dry as the desert**

**when you look at another one  
death stands close beside me**

## **KËMBANË MALLI**

**një këmbanë prore bie  
mosardhjen tënde ta zgjojë**

**një drenushë vrapon me kokën e ngritur në qiell  
pranë kroit e etur vdes**

**një zog pa çerdhe e fole  
vetmia e mbyt**

**në shkretëtirën e një zemre  
një banori të vetmuar vendi vend s'i zë  
malli për ty**

## **LONGING'S BELL**

**a bell rings constantly  
to signify your absence**

**a deer runs with its head held high  
and dies of thirst beside the stream**

**a bird without a nest  
dies of loneliness**

**in the heart's desert  
a single soul finds no rest  
from its longing for you**

## **PRORE ME TY**

**unë nuk hidhërohem  
kur hidhërohem  
kur qaj  
unë nuk qaj**

**unë nuk jam vetem  
kur jam vetem  
kur të vdes  
unë nuk vdes**

**unë prore jam me ty  
madje, kur s'jam me ty**

## **ALWAYS WITH YOU**

**I am not sorrowful  
when I am sorrowful  
when I cry  
I do not cry**

**I am not alone  
when I am alone  
when I die  
I do not die**

**I am constantly with you  
even when I am not with you**

## **AS NË TOKË AS NË QIELL**

**-tim vëlla, Kadrushit**

**-jo, or vëllai im, ti nuk je rrakatur, madje fort mirë je  
kjo është po ajo lagje, po ajo shtëpi, po ajo dhomë, po ajo kanape  
por, aty kurrë më s'do të më gjesh mua  
ka kohë që e kam ndërruar adresën  
nuk banoj më në kufomën e qenies sime  
e, tani sa para bën për ty, nëse e mëson vendbanimin tim të ri?**

**megjithatë, ja ku e ke kartëvizitën time  
as në tokë, as në qiell,  
rruga-zemra e Doruntinës  
pa numër**



## **NEITHER ON EARTH NOR IN HEAVEN**

**to my brother, Kadrush**

**no, my brother, you are not confused, you are very well  
this is the same neighborhood, same house, same room, same sofa  
but you will never meet me here again  
it is a long time since I changed address  
I am no longer in the coffin of my being  
and to what avail if you knew my new hometown**

**anyway, here is my card:  
neither on earth nor in heaven  
street address-Doruntina's heart  
no number**

## **FJALA JOTE**

**-shokut tim, Hazyr Dervishit**

**më virtuoze se vet Paganini  
kur i bie violinës së gëzimit pa asnjë tel**

**ma vë në gjumë si foshnjën  
dinosaurin e pikëllimit tim**

**vetmisë sime binjake  
lakun ia heq prej fytit**

**me shpejtësi drite mur kinez ndërton  
mllefin tim mongol e lë me gishta në gojë**

**jo rrallë, fuqishëm e mbanë për dore qenien time  
të papeshë, të paadresë**

**fjala jote  
e urtë**

## **YOUR WORD**

**to my friend, Hazyr Dervishi**

**more virtuosic than Paganini  
when he plays on the stringless violin of joy**

**your word puts to bed like an infant  
the dinosaur of my sorrow**

**it frees my twin loneliness  
from the noose around its neck**

**it builds a Chinese wall overnight  
and starves to death my Mongolian fright**

**not seldom, it holds fast  
my weightless, elusive being**

**your wise  
word**

## **GATNIKU**

**mes tokës e qiellit  
mes njerëzve e egërsirave  
mes fushave e pyjeve  
mes blerimit e venitjes  
mes territ e dritës  
mes të mirës e të keqes  
mes jetës e vdekjes  
mes premtimit tënd e mallit tim për Doruntinën  
ti shtrihesh aq i qetë  
o Gatnik i largët!  
o Gatnik i afërt!  
o varri im i hapur!**

## **GATNIKI**

**between heaven and earth  
between people and animals  
between plains and forests  
between growth and withering  
between dark and light  
between good and evil  
between life and death  
between your promise and my longing for Doruntina  
you lie there so calmly  
oh Gatniki so far away  
oh Gatniki so near  
oh my open grave**

## **DUA TË TË HARROJ**

**besën po ta jap se dua të të harroj  
as emrin më s'do ta përmendi  
pas vdekjes**

## **I WANT TO FORGET YOU**

**I pledge my sacred word, besa, that I want to forget you  
I won't even say your name  
when I am dead**

## **VJESHTA**

**diçka e tmerrshme po vjen  
gjethet cofët në tokë po bien  
e qielli po qan me ngashërim...  
le të ikin ata që mund të ikin  
unë po strukem në vegimet e mia për Doruntinën  
atje askush s'mund të më gjejë  
në këtë vjeshtë**



## **AUTUMN**

**something terrifying is coming  
leaves fall heavily to the ground  
and heaven is sobbing  
let them escape those who can  
I will hide in my visions of Doruntina  
where nobody can find me  
in this autumn**

## **ZEMRA E POETIT**

**nuk është dritë çdo dritë  
hënë nuk është çdo yll**

**çdo lule nuk është trëndafil**

**s'është mall çdo mall  
dashuri nuk është çdo dashuri**

**vaj! për zemrën e poetit  
falur Doruntinës**

## **THE POET'S HEART**

**every light isn't daylight  
every star isn't a moon's proxy**

**every flower isn't a rose**

**every longing is not Longing  
every love is not Love**

**woe for the poet's heart  
given to Doruntina**

## **DASHURI POETI**

**të thash kur u ndamë  
kurrë më mos e dashuro poetin  
vishet pa shije  
mantelin vjeshtor në dimër  
vallëzimet e reja s'i di...  
ai di veç të dashurojë deri në vdekje  
dhe, asgjë tjetër**

## **THE POET'S LOVE**

**when we parted I warned you  
never love a poet again  
he dresses without taste  
in winter he wears an autumn raincoat  
and knows nothing of fashionable dances  
he knows only how to love until his death  
and nothing else**

## **MALLI**

**malli është dhembje pa pikë e presje  
nuk ndihmon as djepi i kujtimit më të ëmbël  
malli është dëshpërim vetullngrysur  
që s'di ku ta lësh vetveten për një çast  
është klithmë në shkretëtirën e vetmisë së pafund  
kujtim i diçkaje që s'kthehet më kurrë  
malli, për shembull, është kjo poezi për Doruntinën**

## **LONGING**

**longing is a pain without period or comma  
it does not help, even the cradle of the sweetest memory  
longing is a bitter despair  
when you don't know where your place is for a single moment  
it is a scream in the desert of unending loneliness  
the memory of something that will never return  
longing, for instance, is like this poem about Doruntina**

## **NË PLAZH**

**o, Zot! sa njerëz të rëndomtë ke krijuar  
i zhveshin rrobat në plazh  
rreziten në diell  
dhe, me zemra të akullta kujtojnë  
se po i ngroh dielli i lumturi së  
edhe pse kurrë në jetë pa s'e kanë  
Doruntinën**



## **ON THE BEACH**

**oh God, so many common people you created  
they undress on the beach  
they bask in the sun  
and think with an ice-cold heart  
that the sun of happiness shines on them  
even though they have never in their lives  
seen Doruntina**

## **NDARJA**

**ndarja është pamundësia apokaliptike  
toka poshtë e qielli lart  
zbulimi i kontinentit të panjohur të dhembjes  
përbirimi nëpër vesh të gjilpërës  
zemra e ndarë më dysh  
rënja pingul në vetvete  
pa asnjë gjurmë  
e varr**

**tani e pamundshmja duhet bërë e mundshme  
peshku duhet mësuar të jetojë në tokë  
e njeriu në ujë  
deti të jetë i cekët  
largësia të jetë e afërt  
foshnjat ta mësojnë alfabetin kinez  
kokrra e rrufesë të bëhet trëndafil  
po të betohem se të pamundshmen do ta bëj të mundshme  
po, si do ta mësoj vetveten pa ty?  
Zotynë i Madh më ndihmoftë!**

**po, ç'tu desh kjo punë  
o fati im i pafat?  
tani unë si do t'i zbres në tokë  
gjithë ato mendime për Doruntinën  
që vërtiten si kosmonautë në Gjithësinë e kokës sime?  
vallë, pse s'më lë në përditshmërinë e përhimtë të jetës  
gjuhën e së cilës e pata mësuar për mrekulli?  
vetë Zoti që është Zot zor se do ta krijonte botën sërish  
e lëre më unë, poeti, t'ia nis prej germës A kësaj bote pa ty  
Zotynë më ndihmoftë!**

## FAREWELL

farewell is an apocalyptic impossibility  
the ground down there and the sky up there  
it is the discovery of the unknown continent of pain  
snaking through the eye of the needle  
a heart split in two  
the vertical falling into yourself  
without a trace, without a grave  
II.

now the impossible must become possible  
fish must learn to live upon dry land  
and people in water  
the sea must learn to be shallow  
distance to become vicinity  
babies are to learn the Chinese alphabet  
and the thunderbolt to turn into a rose  
I swear I will make the impossible possible  
but how can I get used to being without you  
May God help me

III.

what were you up to  
you my unhappy destiny  
now how will I bring down to earth  
all these thoughts of Doruntina  
that spin around like astronauts  
in the space of my head?  
why am I not allowed to stand in the gray of everyday life  
whose language I impeccably understood  
not even God, being what he is, would recreate the world  
and how can I, the poet, start over from scratch  
in this life without you  
May God help me

## **E SHKRUAR ME GJAK**

**këtë poezi po ta shkruaj me gjakun tim  
ti kot do t'i bësh analizat spektrografike  
dashuria ime është shumë më e lashtë  
se sa ndarjet e gjakut në grupe A, B, O...**

## **WRITTEN IN BLOOD**

**this poem I write with my blood  
no point in making spectrographic analysis  
my love is of a much older make  
than the divisions in blood groups A, B, O...**

**VETËM TI**

**pas çdo lindje të sërishme  
tmerrshëm prapë do të dashurohesha  
veç në ty**

**ONLY YOU**

**after every rebirth  
I would again be terrifically in love  
only with you**

## **TESTAMENTI**

**plotësisht i vetëdijshëm kam vendosur  
secilit t'ia lë hisen e vet  
nënës ia lë pikëllimin e pafund e të gjerë sa fushat e Kosovës  
vëllait dhembjen që s'do ta shërojë kurrë  
shokut vetminë e varrit  
Doruntinës  
poezitë**



## **MY TESTAMENT**

**being fully aware I have decided  
to give everyone his share:  
to mamma, my perpetual sadness, as wide as Kosova's fields  
to my brother, my incurable pain  
to my friend, the grave's loneliness  
and to Doruntina  
my poetry**

## **EPITAF**

**kur të vdes, ju lutem mos më qani  
sytë m'i mbyllni, nëse të hapur ngelin  
le ta ëndërrojnë përjetë Doruntinën**

## **EPITAPH**

**when I am gone, please don't cry  
just close my eyes, if they remain open  
let them dream eternally of Doruntina**

## **FATI IM**

**ijeve shëndetliga të jetës sime  
prore më godite me brirët tua  
o dem i zi!  
o fati im!**

**si shami e kuqe toreadori  
të është bërë kjo qenia ime  
o i uruar!**

**po të betohem se një ditë  
keq do të të mund  
në jetën time  
të Pasvdekjes**

## **MY FATE**

**on ailing hips of my life  
you struck me with your horns  
time and again  
you black bull  
of my fate**

**My being has become to you  
like a red cape in the toreador's hand  
bless your heart oh strange fate**

**I pledge my word that one day  
I will wrestle you down  
in my life on the other side**

## **KROI**

**gurgullon**

**rrjedh**

**pikon**

**kur t'i soset edhe pika e fundit e gjakut**

**si engjëll, padiktueshëm jep shpirt**

**në kufomën e**

**në varrin**

**e vet**

## **THE SOURCE**

**it gushes**

**it flows**

**it pours**

**until the last drop dries up in its vein**

**then like an angel it gives its last breath unnoticed**

**in its dust and**

**in its grave**

## **ZOTIT**

**ata më të mençurit të dëbuan  
përtej qiejve  
përtej harrimit  
me vetminë e tmerrshme të dënuan  
po ti, tinëza u hakmerresh  
atyre që ende të besojnë**



## **TO GOD**

**the most intelligent ones banished you  
beyond the heavens  
beyond the end of memory  
they sentenced you to a terrible solitude  
but you sneakily take revenge  
on those who still believe in you**

## **NDËRGJEGJJA**

**aq sa prej vdekjes  
askund s'po mund të ik  
prej gishtit tënd tregues**

## **CONSCIENCE**

**as I cannot escape death  
nowhere can I run away  
from your warning finger**

## **KAH VDEKJA**

**paska rënë borë e madhe  
mbi vitet e mia  
e veç një shteg ma paska lënë  
kah vdekja**

**varrmihës, mos rrëmoni thellë!  
se e pat ajo: sot këtu e nesër Zoti e di se ku?  
tani kam kohë të ngathët, që s'plaket kurrë  
dhe me përkushtim do ta ndreq vetë  
varrin  
tim**

## **TOWARDS DEATH**

**so much snow has fallen  
over my years  
and only a path is left  
towards death**

**grave digger, don't dig so deeply  
for so I lived: today here, tomorrow God knows where  
now I have dawdling time, that never ages  
and with dedication I will build on my own  
my grave**

## **BALADË PËR POETIN**

**e kërkohet në qiell e në tokë  
varr s'lenë pa shpluar  
por s'e gjejnë dot  
mbi plep të lartë të një balade  
një zog prore e vajton**

## **BALLAD OF THE POET**

**they search for him between heaven and earth  
old graves are dug up  
they don't find him  
but up in a ballad's tall poplar  
a bird laments him day and night**

**P Ë R M B A J T J A:**  
**C o n t e n t s :**

---

**N Ë N Ë S**

**TO MOTHER**

|                                      |                                  |
|--------------------------------------|----------------------------------|
| 1.Nënës.....                         | To mother                        |
| 2.Krushqit.....                      | The bridegroom escorts           |
| 3.Nusja.....                         | The bride                        |
| 4.Dhëndëri.....                      | The bridegroom                   |
| 5.Shqipëria.....                     | Albania                          |
| 6.Kosovës.....                       | To Kosova                        |
| 7.S'paksa Zot, as Perëndi.....       | There is no lord, no God         |
| 8.Armiqtë.....                       | The enemies                      |
| 9.Vallja dyshe e shekullit XXI.....  | Twenty-first century dance       |
| 10.Do të ngrihemi sërish.....        | We will rise again               |
| 11.Emri im i pavdirë.....            | My name will not die             |
| 12 - 16.Kopilat e Adamit.....        | Adams stepchild                  |
| 13.Dhunimi i Shën Paqes Virgjër..... | The rape of the goddess of peace |
| 14.Kashë e lashë.....                | The riddle                       |
| 15.Lajmet.....                       | News                             |
| 16.Kosovari i mërguar.....           | Kosovars in exile                |
| 17.Ditë vere në Dukagjin I. II.....  | A summer day in Dukagjini I. II. |
| 18.Lektisje e pashuar.....           | Unquenchable longing             |



## FOLE E DHEMBJES SË BUKUR

### THE ABODE SWEET PAIN

- 19.Frymëzimi.....Inspiration  
20.Poezi biblike.....Bible poetry  
21.Kryevepra e Zotit.....God's masterpiece  
22.Hyn gjarpëri e del nuse shatselvi.....Through the magic ring of your beauty  
23.Një lloj drite tjetër.....Another type of light  
24.Agon në ëndrra.....To wake with a dream  
25.Kaltëron det e qiell.....Blue sea blue heaven  
26.Askund s'të lënë të qetë.....Nowhere do they leave me in peace  
27.Sytë e tu.....Your eyes  
28.Letra.....The letter  
29.Ditë vere.....Summer day  
30.Natë vere.....Summer night  
31.I dashuruari.....The infatuated  
32.Brenda një dite.....Within a day  
33.Shpirt hyjnor.....Heavenly spirit  
34.Edhe më e bukur në ëndrra.....Even lovelier in dreams  
35.Fole e dhembjes së bukur.....The abode of sweet pain  
36.Pa titull.....Without title  
37.Njësoj e bukur.....Just as beautiful  
38.Një dritë që s'fiket kurrë.....A light that never goes out

## NJË ZOG PRORE E VAJTON

### A BIRD' OF LAMENT

|                                 |                                |
|---------------------------------|--------------------------------|
| 39.Asgjë prej qiellit.....      | Nothing of heaven              |
| 40.Xhelozia.....                | Jealousy                       |
| 41.Këmbanë malli.....           | Longing's bell                 |
| 42.Prore me ty.....             | Always with you                |
| 43.As në tokë, as në qiell..... | Neither on earth nor in heaven |
| 44.Fjala jote.....              | Your word                      |
| 45 Gatniku.....                 | Gatniki                        |
| 46.Dua të të harroj.....        | I want to forget you           |
| 47.Vjeshta.....                 | Autumn                         |
| 48.Zemra e poetit.....          | The poet's heart               |
| 49.Dashuri poeti.....           | The poet's love                |
| 50.Malli.....                   | Longing                        |
| 51.Në plazh.....                | On the beach                   |
| 52.Ndarja I, II, III.....       | Farawell, I, II, III           |
| 53.E shkruar me gjak.....       | Written in blood               |
| 54.Vetëm ti.....                | Only you                       |
| 55.Testamenti.....              | My testament                   |
| 56.Epitaf.....                  | Epitaph                        |
| 57.Fati im.....                 | My fate                        |
| 58.Kroi.....                    | The source                     |
| 59.Zotit.....                   | To God                         |
| 60.Ndërgjegjja.....             | Conscience                     |
| 61.Kah vdekja.....              | Towards death                  |
| 62.Baladë për poetin.....       | Ballad of the poet             |

# **S H E F K I O S E K U**

**Një lloj drite tjetër**

**Another type of light**

**Poezia shqipe-anglisht**

**Poetry in Albanian with English interpretation**

---

**Përkthyer nga shqipja në anglisht**

**Translated from Albanian to English**

**Ferhat Ymeri**

**Jennifer Claesson**

---

**Përpunimi kompjuterik**

**Computer responsibility:**

**Frashër Oseku**

---

**Botimi i parë, tirazhi 1.000 copë**

**First publication, 1.000 examples**

---

**Libri u botua me ndihmën e ABF-it në Treleborg-Suedi**

**The book is published with help of ABF in Trelleborg-Sweden**

---

**U dorëzua në shtyp në janar të vitit 2008**

**Print date Januari 2008**

**BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG, SUEDI, 2008**

**Published by the journal of "Drita" Trelleborg, Sweden, 2008**



## **SHEFKI OSEKU**

**U lind më 15.03.1943 në Gjakovë, Kosovë. E ka të kryer Fakultetin e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe si dhe atë Juridik. Në Kosovë ka punuar si arsimtar i gjuhës shqipe, por edhe si nëpunës. Tani punon si arsimtar i gjuhës shqipe në Treleborg. Është kryeredaktor i redaksisë "Drita", në kuadër të së cilës janë botuar disa vepra letrare.**

**Për herë të parë më 1997, në Treleborg të Suedisë, e ka botuar përmbledhjen me poezi "Një lloj drite tjetër". Më vonë ky libër është ribotuar disa herë, por edhe është përkthyer në gjermanisht, suedisht, polonisht dhe anglisht. Shefki Oseku merret edhe me prozë.**

**Në vitin 2000 autori e ka botuar romanin e parë në gjuhën shqipe, të shkruar në Suedi, me titull: "Hetimet".**



## **SHEFKI OSEKU**

**Born on March 15th, 1943, in Gjakova, Kosova. He has gone through University Studies at the Faculty of Albanian Language and Literature including the Faculty of Law. In Kosova, he worked as a teacher in Albanian language but also in an administrative capacity. He is now a teacher of the Albanian language in Trelleborg. He is Chief Editor for the journal "Drita" and has, through this activity, produced many literature works. The first version of the poetry collection "Another Type of Light" came out in Trelleborg in 1977. Later this book was published in new collections, and also translated to German, Swedish, Polish and English. Shefki Oseku is also devoted to prose; in the year 2000, he published his first novel in Albanian, written in Sweden, with the title "Hetimet" - "The Interrogation".**